

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fage 1 nga 37</i>

KODI I RRJETIT - KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri i Kompanisë	KOSTT	KOSTT	ZRrE
Data	22.11.2010	09.12.2010	10.09.2010

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje.....	5
2	Kodi i Planifikimit të Ndërprerjeve.....	6
2.1	Parathënie.....	6
2.2	Objektivi.....	6
2.3	Fushëveprimi.....	7
2.4	Përmbledhje.....	7
2.5	Standardet e Mirëmbajtjes së Sistemit të Transmisionit.....	7
2.6	Procedura për Ndërprerjet që Ndikon mbi Sistemin e Transmisionit.....	8
2.6.1	Përshkrim i Përgjithshëm.....	8
2.6.2	Shtrirja kohore.....	8
2.6.3	Propozimet Fillestare.....	10
2.6.4	Orari Paraprak i Ndërprerjeve.....	11
2.6.5	Orari Final i Ndërprerjeve.....	12
2.7	Ndërprerjet e Sistemit të Transmisionit dhe Përdoruesve.....	12
2.7.1	Ndërprerjet e planifikuara.....	12
2.7.2	Ndërprerje të Paplanifikuara.....	13
2.7.3	Ndryshimet e Kërkuara nga OSTT.....	14
2.7.4	Ndryshimet e Kërkuara nga Përdoruesit.....	14
2.7.5	Situatat e Emergjencës.....	15
2.7.6	Njoftimet për Ndërprerje të Detyruar dhe për shkak të Defekteve tek Përdoruesit dhe OSTT.....	15
3	Kodi i Vlerësimit të Sistemit.....	17
3.1	Parathënie.....	17
3.2	Objektivat.....	17
3.3	Fushëveprimi.....	17
3.4	Parashikimet e OSTT.....	17
3.4.1	Të Përgjithshme.....	17
3.4.2	Parashikimet e Ngarkesës.....	18
3.4.3	Pengesat e Sistemit të transmisionit.....	18
3.4.4	Publikimet e Parashikimeve.....	19
3.5	Informacioni që i duhet dhënë OSTT.....	19

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

3.5.1	Të përgjithshme	19
3.5.2	Mujore	19
3.5.3	Javore.....	20
3.5.4	Çdo ditë.....	20
3.6	Parashikimet e Gjenerimit	20
3.6.1	Të përgjithshme	20
3.6.2	Mujore	20
3.6.3	Javore.....	21
3.6.4	Çdo ditë.....	21
3.7	Parashikimi i Ngarkesës për Ditën në Vazhdim.....	21
3.7.2	Përmbajtja e Parashikimit të Ngarkesës për Ditën në Vazhdim.....	22
3.7.3	Freskimi i Parashikimit të Ngarkesës.....	22
3.7.4	Raportimi i Operatorit të Sistemit.....	22
3.8	Kërkesat për Rezerva.....	23
3.9	Kapaciteti i Interkonekcioneve	23
3.10	Mënyra e Rastësishme	23
3.11	Vlerësimi i Sigurisë.....	23
3.11.1	E Përgjithshme.....	23
3.11.2	Procesi.....	24
3.11.3	Grumbullimi i informacionit.....	24
3.11.4	Analiza e Informacionit	24
3.11.5	Ruajtja e Fshehtësisë	25
3.11.6	Publikimi.....	25
3.12	Vlerësimet e Sigurisë të Sistemit Energjetik (PSSA-të)	25
3.12.1	PSSA Mujore.....	25
3.12.2	PSSA-të sezonale	26
3.12.3	PSSA-të javore	27
3.12.4	E Përgjithshme.....	27
4	Kodi i Planifikimit Kohor	28
4.1	Parathënie.....	28
4.2	Objektivat.....	28
4.3	Fushëveprimi	29

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

4.4	Dorëzimet nga Palët Tregtare	29
4.4.1	Të përgjithshme	29
4.4.2	Lajmërimet Fizike (PN)	29
4.4.3	Parametrat e të Dhënave Dinamike.....	30
4.4.4	Kontrollimi dhe Miratimi i Dorëzimeve	30
4.4.5	Trajtimi i Dorëzimeve të Pavlefshme	30
4.4.6	Ofertat dhe Propozimet	31
4.4.7	Pezullimi i Tregut të Energjisë Elektrike.....	31
4.4.8	Shërbimet Ndhmëse.....	31
4.4.9	Komunikimet	32
4.4.10	Formati i Orareve	32
4.4.11	Ditët që nuk janë ditë pune.....	32
4.4.12	Ndryshimet të Orareve të Aprovuara në Rast Emergjence.....	32
5	Shtojca 1 – Parametrat e të Dhënave Dinamike	34
5.1.1	E përgjithshme.....	34
5.1.2	Të dhënat e Disponueshmërisë	34
5.1.3	Të Dhënat e Shkallës së Devijimit	34
5.1.4	Kufijtë Operativ.....	35
5.1.5	Kërkesat për Njoftim	35
5.1.6	Informacion tjetër për Njësinë Gjeneruese	35
5.1.7	Caktimi i Orareve nga Ana e Ngarkesës dhe Parametrat e Dispeçimit (DSP). 36	
6	Burimet dhe Dokumentet	36

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 2 nga 37</i>

Kapitulli 5: Kodi i Planifikimit Operativ

1 Hyrje

1.1.1.1 Ky **kod i planifikimit operativ** mbulon periudhën prej një viti në vazhdim deri në fazën e balancimit në kohë reale. Mbulon planifikimin e ndërprerjeve, vlerësimin e sistemit dhe caktimin e orareve për ditën në vazhdim.

1.1.1.2 Ky **kod i planifikimit operativ** nuk është një njësi e vetme por përbëhet nga nënkodet e mëposhtme (këtej e tutje i referuar si kodi):

- **Kodi i planifikimit të ndërprerjeve**
- **Kodi i vlerësimit të sistemit**
- **Kodi i programimit kohor**

1.1.1.3 Për të përmbushur përgjegjësitë e tij sipas **kodit të planifikimit operativ OSTT** kërkon informacion prej **përdoruesve** brenda Kosovës. Këta **përdorues** janë të detyruar me ligj të ofrojnë këtë informacion plotësisht në formatin e kërkuar dhe për të përmbushur shkallën kohore të kërkuar. **OSTT** gjithashtu kërkon informacion nga **palët e interkonektuara**. Megjithatë këto **palë të interkonektuara** nuk janë të detyruara nga kërkesat e këtij **Kodi të Rrjetit** por nga marrëveshje të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe. Prandaj aty ku ky **Kod i Rrjetit** i referohet informacionit prej **palëve të interkonektuara** dhënia e këtij informacioni është subjekt i shpjegimit më sipër.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

2 Kodi i Planifikimit të Ndërprerjeve

2.1 Parathënie

2.1.1.1 Ky kod përcakton procedurat si më poshtë:

- Koordinimin dhe aprovimin e **ndërprerjeve** të planifikuara të **njësive prodhuese (gjeneruese)**;
- Koordinimin e **ndërprerjeve** të planifikuara në **Sistemin e Transmisionit** dhe të **stabilimentit elektrik** dhe **aparateve** të lidhur direkt me **Sistemin e Transmisionit**;
- Shkëmbimin e nevojshëm të informacionit ndërmjet **OSTT** dhe **përdoruesve** për përpilimin e planeve të **ndërprerjeve** për **Sistemin e Transmisionit**;
- Shkëmbimin e informacionit me **TSO-të** e tjera në lidhje me **ndërprerjet** që kanë ndikim në interkonekcionet ndërshtetërore¹;
- Hapat që duhen ndërmarrë nga **OSTT** për të trajtuar **ndërprerjet** e paplanifikuara.

2.2 Objektivi

2.2.1.1 Objektivi i këtij **kodi të planifikimit të ndërprerjeve** është të përpiqet të sigurojë që ndërprerjet e të gjitha **njësive prodhuese (gjeneruese), përdoruesve** të kyçur drejtpërdrejt në **Sistemin e Transmisionit** dhe **ndërprerjet** në **Sistemin e Transmisionit** janë të aprovuara dhe të koordinuara. Koordinimi kërkohet për të siguruar se siguria dhe cilësia e standardeve të furnizimit në **Sistemin e Transmisionit** janë plotësuar dhe me aq sa është e mundur të minimizohet numri dhe efekti i pengesave në **Sistemin e Transmisionit**.

2.2.1.2 Ky **kod i planifikimit të ndërprerjeve** duhet të kërkojë të sigurojë përcaktimin e procedurave të duhura që lejojnë koordinimin mes **OSTT** dhe **TSO-ve** fqinje në lidhje me **ndërprerjet** që kanë ndikim në flukset e energjisë së interkonekcionit.

¹ Ky informacion është në dispozicion sipas kushteve të marrëveshjeve të interkonekcionit

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 37</i>

2.3 Fushëveprimi

2.3.1.1 Ky kod i planifikimit të ndërprerjeve aplikohet tek:

- **OSTT**;
- **Gjeneruesit të cilët kanë njësi prodhuese (gjeneruese) të lidhura me Sistemin e Transmisionit**;
- **OSSH-të**;
- **përdorues të tjerë të lidhur direkt me Sistemin e Transmisionit.**

2.4 Përmbledhje

2.4.1.1 Qëllimi i këtij kod i planifikimit të ndërprerjeve është të sigurojë që përdoruesit ofrojnë informacionin që është i nevojshëm që:

- Të sigurojë funksionimin e sigurt të **Sistemit të Transmisionit**.
- Të lejojë **OSTT** që të përfundojë llogaritjet mbi efektin që **ndërprerjet** kanë mbi flukset e energjisë në **interkonekcion**:

2.4.1.2 Shtrirja e këtij informacioni varet nga përmasa, vendndodhja dhe lloji i instalimit të **përdoruesit** dhe nëse informacioni i ofruar në ndonjë periudhë konfirmon apo jo të dhënat e ofruara më parë.

2.5 Standardet e Mirëmbajtjes së Sistemit të Transmisionit

2.5.1.1 **OSTT** duhet të mirëmbajë **Sistemin e Transmisionit** sipas standardeve aktuale për mirëmbajtjen, inspektimin, riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve të transmisionit. Këto standarde do të sigurojnë shërbim të sigurt, të besueshëm dhe me cilësi të lartë dhe do të marrin në konsiderim koston, gjeografinë lokale dhe motin, standardet e aplikueshme për siguri dhe cilësi të furnizimit, praktikat kombëtare të industrisë elektrike, përvojën dhe gjykimin e saktë teknik.

2.5.1.2 Sistemi i mirëmbajtjes dhe riparimit duhet të sigurojë që punimet të kryhen në periudha të caktuara dhe sipas një procedure të përcaktuar. Të dyja këto kanë për qëllim t'i mbajnë pajisjet e **Sistemit të Transmisionit** në gjendje pune në mënyrë të besueshme dhe efikase me inputin optimal të punës dhe materialeve.

2.5.1.3 Puna që duhet të kryhet do të përfshijë:

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Mirëmbajtjen e pajisjeve;
- Riparime të planifikuara dhe parandaluese të pajisjeve

2.5.1.4 **OSTT** dhe **përdoruesi** duhet të planifikojnë një sistem mirëmbajtje dhe riparimesh të organizuara dhe parandaluese në **Sistemin e Transmisionit** në përputhje me kërkesat ekzistuese dhe me këtë **Kod të Rrjetit** dhe duke marrë parasysh kushtet specifike lokale.

2.5.1.5 Përgjegjësia për mirëmbajtjen, riparimet, azhurnimin dhe renovimin e pajisjeve të **Sistemit të Transmisionit** do të mbahet nga **OSTT**.

2.6 Procedura për Ndërprerjet që Ndikon mbi Sistemin e Transmisionit

2.6.1 Përshkrim i Përgjithshëm

2.6.1.1 **OSTT** duhet të jetë përgjegjës për koordinimin e **ndërprerjeve** të planifikuara në **transmision** me **ndërprerjet** e planifikuara të **njësive prodhuese (gjeneruese)** dhe **përdoruesve** të tjerë të lidhur direkt me **Sistemin e Transmisionit**. Është thelbësore që të gjitha planifikimet individuale të **ndërprerjeve** të koordinohen në mënyrë që të garantojnë sigurinë dhe stabilitetin e funksionimit të të gjithë **sistemit energjetik**. Në mënyrë që t'ia arrijë këtij qëllimi të përgjithshëm **OSTT** duhet të veproj si më poshtë:

- Të rishikojë dhe koordinojë datat e provave për **ndërprerjet** e planifikuara për **transmision, gjenerim, shpërndarje** dhe **përdorues** të tjerë;
- Të komunikoj me **palët** e lidhura për të ndihmuar në përpjekjet për minimizimin e funksionimeve të parashikuara të kufizimeve;
- Të rekomandoj përshtatjet në **ndërprerjet** e planifikuara përgjatë vitit në mënyrë që të përmirësojë koordinimin në oraret e planifikuara të **ndërprerjeve**:

2.6.2 Shtrirja kohore

2.6.2.1 Programi vjetor i **ndërprerjeve** përbëhet nga oraret individuale vjetore të **ndërprerjeve** për **stabilimentet dhe aparatet e përdoruesit** përkatës. Po ashtu përfshin **ndërprerjet** në **Sistemin e Transmisionit** dhe **ndërprerjet** në **Sistemin Shpërndarjes**. Datat sipas të cilave veprimet e ndryshme duhet të kryhen janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Veprimi	Data	Nga Kush
Orari i ndërprerjeve për linjat e transmisionit dhe pajisjet e transmisionit	[Korrik]	OSTT
Orari i ndërprerjeve për pajisjet shpërndarëse që ndikon mbi transmisionin	[Korrik]	OSSH
Aplikimi për njësi prodhuese (gjeneruese) dhe orari i ndërprerjeve të transmisionit të tij të lidhur	[Shtator]	Gjeneratorët
Harmonizimi i planeve të ndërprerjeve të transmisionit dhe shpërndarjes me planet e gjenerimit të ndërprerjeve – zhvillimi i planit të propozuar për ndërprerjet	[Tetor]	OSTT /OSSh/ Gjeneratorët
Negocimi i planit të propozuar për ndërprerjet me Qendrat e Dispečimit të shteteve fqinje	[Tetor]	OSTT
Aprovimi i orareve finale	[Nëntor]	OSTT
Lëshimi i orarit final të dakorduar	[Nëntor]	OSTT
Fillimi i orarit të ndërprerjeve	[Jan] Viti+1	Të gjithë

2.6.2.2 Orari vjetor i planifikuar për **ndërprerjet** do të përgatitet duke përdorur një proces me dy faza që pason dorëzimin e informacionit për **OSTT**. Së pari **OSTT** do të konsiderojë **ndërprerjet** e propozuara në **Sistemin e Transmisionit** dhe **ndërprerjet** e **interkonektorëve** dhe të **pajisjeve** të **shpërndarjes** që mund të ndikojnë mbi **Sistemin e Transmisionit**. Informacioni për kryerjen e këtij ushtrimi duhet të jetë i gatshëm deri në Korrik.

2.6.2.3 **OSTT** në përgatitjen e draftit të parë të orarit do të veprojë në mënyrë jo-diskriminuese duke iu dhënë përparësi **përdoruesve** në baza rrotative. **OSTT** do të diskutojë çdo **kyçje** me **palët** e përfshira. Faza e dytë do të ndërmerret pasi i gjithë informacioni mbi **ndërprerjet** në **njësitë prodhuese (gjeneruese)** është i gatshëm në [fillim të Shtatorit]. Në rast se ka ndonjë konflikt **OSTT** do t'i diskutojë ato me **palët** e përfshira. Nëse nuk mund të arrihet asnjë zgjidhje me marrëveshje atëherë **OSTT** do

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

të marrë vendimin final dhe do të nxjerrë propozim planin e **ndërprerjeve** [në fund të Shtatorit], i cili do t'i komunikohet **Rregullatorit**.

2.6.2.4 Faza finale në proces është harmonizimi i planit të propozuar për **ndërprerjet** në lidhje me oraret e **ndërprerjeve** për interkonektorët me shtetet fqinje. Pasi të kryhet marrëveshja [deri në mes të Tetorit] **OSTT** do të aplikojë korrektimet e nevojshme dhe do të nxjerrë planin final të **ndërprerjeve** deri në [mesin e Nëntorit].

2.6.2.5 Në përgatitjen e këtij orari, **OSTT** do të përpiqet, me sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, të kënaqë kërkesat e të gjitha **palëve** plus kërkesat e **planit për zhvillimin e Sistemit të Transmisionit (TNDP)**. Sidoqoftë **OSTT** ka një përgjegjësi absolute për mirëmbajtjen e sigurisë dhe cilësisë së standardeve të furnizimit dhe ky do të jetë prioriteti i parë për vendosjen e pozicionimit të **ndërprerjeve** brenda këtij orari. Aty ku **OSTT** përcakton, me gjykimin e tij të arsyeshëm, se **ndërprerjet** e propozuara do të çonin në dhunimin e standardeve të sigurisë dhe/ose cilësisë, **OSTT** do të bëjë ndryshimet e nevojshme në propozimet për **ndërprerje** për ta korrigjuar situatën. Për të bërë këtë arsyetim **OSTT** do të konsiderojë të gjithë faktorët dhe do të veprojë në mënyrë jo-diskriminuese.

2.6.2.6 Në rend të dytë pas kriterëve të sigurisë dhe cilësisë, **OSTT** do të përpiqet të minimizojë kostot e kufizimeve në **transmision** të shkaktuara në situata **ndërprerjesh**. Megjithatë **gjeneratorët** ose **përdoruesit** e tjerë nuk duhet të jenë të obliguar të bien dakord me ndryshimet në propozimet e tyre për **ndërprerjet** vetëm për këtë arsye. Sidoqoftë atyre do t'u kërkohet të konsiderojnë propozimet e bëra nga **OSTT** për këtë arsye, në interes të menaxhimit të përgjithshëm ekonomik të **Sistemit Energjetik** të Kosovës.

Në të gjitha fazat e procesit **OSTT** do të veprojë si një **operator i arsyeshëm dhe i matur**.

2.6.3 Propozimet Fillestare

Kur dorëzon propozime për **ndërprerje përdoruesi** duhet ta bazojë kërkesën e tij në informacionin e mëposhtëm:

- Kërkesat për riparimin dhe mirëmbajtjen e **stabilimentit dhe aparatit** të **Sistemit të Transmisionit**;
- Kërkesat për riparimin dhe mirëmbajtjen e **stabilimentit dhe aparatit** të **përdoruesit** dhe pajisjeve të përdorura për **kyçjen me Sistemin e Transmisionit**;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Analizën e kushteve ekzistuese teknike të **stabilimentit dhe aparatit** dhe pajisjeve të lidhura dhe kontrollet e defekteve nga riparime të mëparshme:

2.6.3.1 Kërkesa do të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:

- Emrin e **stabilimentit dhe aparatit të transmisionit** në fjalë;
- Emrin e **njesisë prodhuese (gjeneruese)** dhe/ose të pajisjeve të **stabilimentit elektrik** në fjalë;
- Emrin e **stabilimentit dhe aparatit shpërndarës** në fjalë;
- Emri i **stabilimentit dhe aparatit konsumues të energjisë** që është i lidhur direkt;
- MW ose kapaciteti në fjalë;
- Kohëzgjatja e kërkuar e **ndërprerjes**;
- Kthimin minimal të kohës së shërbimit (ky mund të jetë i ndryshëm në faza të ndryshme të **ndërprerjes**);
- Data e preferuar e fillimit dhe ora e fillimit ose kufiri i datave të fillimit dhe orëve të fillimit:

2.6.4 Orari Paraprak i Ndërprerjeve

2.6.4.1 **OSTT** do të përgatisë orarin fillestar vjetor të **ndërprerjeve** deri në [fund të Korrikut] duke përfshirë vetëm **ndërprerjet** në **Sistemin e Transmisionit**. Pas arritjes së marrëveshjes paraprake **OSTT** do ta përmirësojë atë pas përfshirjes së **ndërprerjeve** të **njësive prodhuese (gjeneruese)** dhe të **interkonektorëve** për vitin e ardhshëm kalendarik për të dhënë orarin paraprak të **ndërprerjeve**. **OSTT** do t'u shpërndajë të gjithë **përdoruesve** të **Sistemit të Transmisionit** pjesën përkatëse të orarit paraprak vjetor të **ndërprerjeve** jo më vonë se [mesi i Tetorit] të vitit vijues kalendarik. Orari paraprak vjetor i **ndërprerjeve** bazohet në si më poshtë:

- Orarin vjetor të **ndërprerjeve** të **përdoruesve** dhe **OSTT**;
- Orarin vjetor të **ndërprerjeve** për **interkonektorët** sipas marrëveshjeve me **TSO-të** fqinje;
- Parashikimin e ngarkesës vjetore sipas këtij **Kodi të Rrjetit**;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Mbajtjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës;
- Minimizimin e pengesave;

2.6.5 Orari Final i Ndërprerjeve

2.6.5.1 **OSTT** do t'u dorëzojë të gjithë **përdoruesve** të **Sistemit të Transmisionit** dhe **Rregullatorit** pjesën përkatëse të orarit vjetor final të **ndërprerjeve** për vitin e ardhshëm kalendarik jo më vonë se [mesi i Nëntorit] i vitit vijues kalendarik. Pas kësaj date, datat e **ndërprerjeve** siç janë specifikuar në **planin** final vjetor të **ndërprerjeve** janë të detyrueshme për të gjithë **përdoruesit** dhe mund të ndryshohen vetëm në rrethanat e jashtëzakonshme si më poshtë:

- Në raste të kushteve të rrezikshme operative ose sigurisë dhe stabilitetit të **stabilimentit energjetik**;
- Aty ku përndryshe nuk do të kishte kapacitet gjenerues të mjaftueshëm për të përmbushur ngarkesën e parashikuar dhe për të mbajtur standardet e sigurisë dhe cilësisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës;
- Në raste të pengesave serioze në sistemin rajonal të ndërlidhur të **transmisionit**;
- Në rastin e një marrëveshje të ndërsjellët ndërmjet **OSTT** dhe **palës** tjetër;
- Forcat madhore:

2.7 Ndërprerjet e Sistemit të Transmisionit dhe Përdoruesve

2.7.1 Ndërprerjet e planifikuara

2.7.1.1 Në mënyrë që të mbahet vazhdimësia dhe zbatueshmëria e orarit vjetor të planifikuar të **ndërprerjeve**, të gjithë **përdoruesit** duhet t'i dorëzojnë **OSTT** një aplikim, jo më vonë se [data 15] e muajit, në lidhje me çdo **ndërprerje** të planifikuar që do të fillojë në çfarëdo kohe gjatë muajit të ardhshëm.

2.7.1.2 Aplikimi do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- Detajet e punëve dhe/ose testeve që do të ndërmerren;
- Çdo punë paraprake e nevojshme;
- Konfirmimin se të gjitha kontratat etj janë në rregull;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Plan projektin për punimet dhe ndonjë rrezik;
- Kohën e restaurimeve të emergjencave dhe plani përkatës i ndreqjes, nëse është i aplikueshëm²;
- Konfirmimin se të gjitha procedurat e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë janë kryer:
- Listën dhe kontaktet e personelit përgjegjës:

2.7.1.3 Më pas të gjithë **përdoruesit** do të konfirmojnë kërkesat për **ndërprerje** të paktën [shtatë] ditë përpara datës së fillimit të **ndërprerjes të planifikuar**.

2.7.2 Ndërprerje të Paplanifikuara

2.7.2.1 Në rastin e një **ndërprerje** të paplanifikuar **OSTT** do të përdorë renditjen e mëposhtme të prioritetit:

- (i) **Ndërprerjet** e detyruara dhe defektet (emergjencat), këto përfshijnë tejkalimet e **ndërprerjeve** të planifikuara aty ku nuk është e mundur të rivendoset stabilimenti në shërbim;
- (ii) Tejkalimet e **ndërprerjeve** të planifikuara aty ku është e mundur por është ekonomikisht e papranueshme të rivendoset stabilimenti në shërbim;
- (iii) Në rastet e emergjencës ose ndonjë situatë të paplanifikuar, tipet e mësipërme të **ndërprerjeve** kanë përparësi ndaj **ndërprerjeve** të planifikuara;
- (iv) **Ndërprerjet** e papërfshira në orarin vjetor të planifikuar të **ndërprerjeve** por që përmbushin periudhat e njoftimit në paragrafin 2.7.1;
- (v) **Ndërprerjet** e papërfshira në orarin vjetor të planifikuar të ndërprerjeve dhe që nuk përmbushin periudhat e njoftimit në paragrafin 2.7.1 – këto **ndërprerje** do të lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

2.7.2.2 Në rrethana të caktuara **OSTT** mund të merret vesh për **ndërprerje** me **përdorues** që mund të arrijnë në mbingarkesa, si rezultat i një defekti në **sistem**. Prandaj për të lejuar **OSTT** të menaxhojë **sistemin** do të jetë e nevojshme që **përdoruesi** të bjerë

² Ka raste mirëmbajtjeje të ndërprerjeve ku riparimi nuk është i mundur ose merr shumë kohë aq sa është e pa praktikueshme.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

dakord me veprimet pas defektit për të siguruar **sistemin**. Në mungesë të dispozitave të tilla **OSTT** mund të mos lejojë që të ndërmerren **ndërprerjet**.

2.7.2.3 **OSTT** duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të lejuar **ndërprerjet e planifikuara**, duke mbajtur parasysh kostot e konsiderueshme të mundshme për të gjitha **palët** nëse anulohet një **ndërprerje**. Për vendimet e anulimit ose shtyrjes së një **ndërprerje**, dhe aty ku ka alternativa, **OSTT** do të diskutojë prioritetet me **përdoruesit** e ndikuar dhe ndonjë **palë** tjetër të lidhur dhe do të arrijnë në zgjidhjen më të mirë në ato rrethanat. Në të gjitha rastet vendimi final është i **OSTT**.

2.7.3 Ndryshimet e Kërkuara nga OSTT

2.7.3.1 Atëherë kur kushtet aktuale ose të parashikuara të sistemit ndryshojnë në mënyrë të tillë që **OSTT** konsideron se është i këshillueshëm ricaktimi i orareve të **ndërprerjeve të planifikuara** për arsye ekonomike, **OSTT** duhet të informojë **palën** tjetër për situatën. Ata mund të konsiderojnë ndikimin e veprimit me **ndërprerje** dhe mund ose të veprojnë ose ta shtyjnë **ndërprerjen** për më vonë.

2.7.4 Ndryshimet e Kërkuara nga Përdoruesit

2.7.4.1 Pas dorëzimit të orarit final vjetor të **ndërprerjeve, përdoruesit** mund të kërkojnë ndryshime. Këto do të konsiderohen nga **OSTT** (ku koha e lejon) por nuk do të lejohen nëse marrëveshja e tillë do të çonte në shkeljen e standardeve të sigurisë dhe/ose të cilësisë së furnizimit ose shkaktimin e kostove shtesë për pengesat.

2.7.4.2 Në konsiderimin e kërkesave të tilla, **OSTT** do të përpiqet t'i bëjë të mundura **ndërprerjet** nëpërmjet rikonfigurimit të sistemit ose me rinegocim të **ndërprerjeve** të tjera me **palët** e përfshira. Në pajtueshmëri me sa më lart, **OSTT** do të lejoj ose mohoj **ndërprerjet** në **transmision** bazuar në si më poshtë:

- **OSTT** do të koordinoj dhe do të bëjë çdo përpjekje për aprovimin e të gjitha kërkesave për **ndërprerje** në përputhje me funksionimin e sigurt të qëndrueshëm dhe ekonomik të sistemit, dhe do të koordinoj veprimet e nevojshme për të mbajtur sigurinë dhe cilësinë e standardeve të furnizimit;
- **OSTT** mund të mos e lejoj çdo **ndërprerje** të paplanifikuar ose ndryshim në **ndërprerje** edhe nëse nuk ndikon mbi sigurinë dhe cilësinë e standardeve të furnizimit dhe/ose kostot e pengesave por nëse kohëzgjatja e tij e parashikuar është më e madhe se [një] ditë pune;
- **OSTT** mund të mos e lejojë çdo **ndërprerje** të paplanifikuar ose ndryshim në **ndërprerje** nëse **OSTT** përcakton, vetëm me gjykimin e tij, se marrëveshja për **ndërprerje** do të çonte në kosto për shkak të pengesave.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

2.7.4.3 Duhet të kuptohet plotësisht se zhvillimi i një orari të integruar **ndërprerjesh** gjatë një periudhe prej disa muajsh është një proces i përsëritur dhe i ndërlikuar dhe se ndryshimet e mëvonshme do të jenë përgjithësisht të vështira për t'u arritur, sidomos duke pasur parasysh nevojën për të koordinuar **ndërprerjet** e **interkoneksioneve** në nivel rajonal si për UCTE OH P4. Kjo do ishte veçanërisht e vërtetë në periudhën kulmore të **ndërprerjeve**. Aty ku është e mundur të gjitha palët duhet të shmangin kërkesat për ndryshim të orareve të **ndërprerjeve** pas lëshimit të orarit final vjetor të **ndërprerjeve**.

2.7.5 Situatat e Emergjencës

2.7.5.1 **Sistemi energjetik** është gjithmonë i ekspozuar ndaj defekteve dhe **ndërprerjeve** për shkaqe natyrore në pajisjet e **transmisionit** dhe **shpërndarjes** dhe **njësive prodhuese (gjeneruese)**. Në këto raste mund të jetë e nevojshme për **OSTT** të anuloj apo shtyj për më vonë **ndërprerjet** e planifikuara në një kohë të shkurtër, aty ku përndryshe mund të komprometohej siguria dhe/ose cilësia e standardeve të furnizimit.

2.7.5.2 Në situatat e mëposhtme të emergjencës **OSTT** mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Të shtyj për më vonë ose të anuloj ndonjë **ndërprerje** në **transmision**, kur sipas gjykimit të **OSTT**, mund të rrezikoheshin standardet e kërkuara të sigurisë dhe/ose cilësisë së furnizimit në funksionimin e **Sistemit Energjetik** të Kosovës. **OSTT** duhet të njoftoj menjëherë të gjitha palët e përfshira në **ndërprerje** dhe duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për ricaktimin e orareve të **ndërprerjes** në kohën më të hershme të mundshme që është e përshtatshme për të gjitha **palët**;
- Të urdhëroj **ndërprerjen** e punës dhe kthimin në shërbim të një pjese ose pjesëve të stabilimentit aty ku **OSTT** gjykon se vazhdimësia e **ndërprerjes** ose **ndërprerjeve** do të çonte në shkeljen e sigurisë dhe/ose cilësisë së standardeve të furnizimit. Aty ku koha e lejon **OSTT** do të diskutoj implikimet e çdo vendimi të tillë dhe alternativat e mundshme me **palët** e përfshira:

2.7.5.3 Me kërkesën e **palës** dhe/ose të **Rregullatorit, OSTT** do të dorëzoj një raport me shkrim që justifikon arsyet për anulimin apo shtyrjen e një **ndërprerje** të planifikuar.

2.7.6 Njoftimet për Ndërprerje të Detyruar dhe për shkak të Defekteve tek Përdoruesit dhe OSTT

2.7.6.1 Të gjithë **përdoruesit** duhet ta njoftojnë **OSTT** për ndonjë kërkesë për një **ndërprerje** të detyruar të çdo njësie të pajisjeve të **Sistemit të Transmisionit** ose pajisjeje të

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

lidhur me **Sistemin e Transmisionit**, menjëherë sapo **përdoruesi** të bëhet i vetëdijshëm për nevojën.

2.7.6.2 OSTT me marrjen e një njoftimi për nevojën për një **ndërprerje** të detyruar sipas paragrafit 2.7.6.1 do të informojë menjëherë të gjithë **përdoruesit** që mund të ishin të ndikuar nga **ndërprerja**, dhe do të aplikoj të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimin e asaj **ndërprerje** në sigurinë e funksionimit të **Sistemit Energjetik** të Kosovës, sistemeve energjetike fqinje dhe **planit të ndërprerjeve** të rënë dakord.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajë 3 nga 37</i>

3 Kodi i Vlerësimit të Sistemit

3.1 Parathënie

3.1.1.1 Ky kod i vlerësimit të sistemit përcakton procedurat për vlerësimin e sigurisë së sistemit në kohëzgjatjen e funksionimit dhe shkëmbimin e nevojshëm të informacionit për të lejuar **OSTT** të kryej këtë.

3.2 Objektivat

3.2.1.1 Objektivat e këtij kodi të vlerësimit të sistemit janë si më poshtë:

- Të ketë përcaktuar procedura për shkëmbimin e të dhënave të funksionimit duke përfshirë edhe parashikimin e **ngarkesës**;
- Vlerësimi i sigurisë së **Sistemit Energjetik** të Kosovës në afatin operativ të mesëm dhe të gjatë;

3.3 Fushëveprimi

3.3.1.1 Ky kod i vlerësimit të sistemit aplikohet për si më poshtë:

- **OSTT**;
- **Gjeneratorët** përfshirë **gjeneratorët me njësi prodhuese (gjeneruese)** më të mëdha se [1MW] lidhur me **Sistemin e Shpërndarjes**;
- **OSSH-të**;
- **Përdoruesit e ngarkesës** të lidhur direkt me **Sistemin e Transmisionit**;

3.4 Parashikimet e OSTT

3.4.1 Të Përgjithshme

3.4.1.1 Parashikimet e **ngarkesës dhe vështirësive** të paraqitura në këtë paragraf i duhen **OSTT**-it për qëllime operative. **OSTT**-it i nevojiten parashikimet për të konfirmuar se në shkallën kohore funksionale – deri një vit më vonë – do të ketë **gjenerim** të mjaftueshëm për të përmbushur **ngarkesën** dhe kapacitetin e **Sistemit të Transmisionit** të mjaftueshëm për të mundësuar transportimin ndërkohë që përmbushen standardet e sigurisë. Parashikimi i **ngarkesës** ka të bëjë me kërkesat për **fuqi aktive dhe fuqi reaktive**.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

3.4.2 Parashikimet e Ngarkesës

3.4.2.1 **OSTT** do të jetë përgjegjës për paraqitjen dhe publikimin e parashikimeve³ të mëposhtme të **ngarkesës** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës ose për çdo pjesë të tij të përshtatshme si pjesë e informacionit të vlerësimit të sigurisë. **Kërkesa** do të jetë **kërkesë** potenciale e sistemit:

- Çdo [tre] muaj një parashikim të **ngarkesës** maksimale për [një] vitin pasues sipas [javës];
- Çdo [muaj] një parashikim të **ngarkesës** maksimale për [tre] muajt pasues sipas [ditës];
- Çdo javë një parashikim të **ngarkesës** për secilën prej [21] ditëve të ardhshme për secilën [orë]
- Çdo ditë një parashikim për çdo orë të ditës në vazhdim:

3.4.3 Pengesat e Sistemit të transmisionit

3.4.3.1 **OSTT** do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e parashikimeve të mëposhtme të vazhdueshme të **pengesave në Sistemin e Transmisionit** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës – duke përfshirë interkoneksionet ndër-shtetërore – ose për çdo pjesë të tij, si pjesë e informacionit të vlerësimit të sigurisë:

- Çdo [tre] muaj një **parashikim i pengesave** të sistemit në **Sistemin e Transmisionit** për [një] vitin e ardhshëm sipas [javës];
- Çdo [muaj] një **parashikim i pengesave** të sistemit në **Sistemin e Transmisionit** për [tre] muajt e ardhshëm sipas [ditës];
- Çdo javë një **parashikim i pengesave** të sistemit në **Sistemin e Transmisionit** për çdo [21] ditët e ardhshme për çdo [orë];
- Çdo ditë do të përgatitet parashikimi i kongestionit për ditën e nesërme (DACF). Ky DACF do të përgatitet nga **OSTT** së bashku me **TSO**-të e tjera brenda UCTE për të përmbushur kërkesat e marrëveshjeve DACF të UCTE:

³ Nevoja për parashikimet e **kërkesës ditore** të **kërkesës** së ditës në vazhdim mbulohen nga kodi i vlerësimit të sistemit (brenda **kodit të planifikimit operativ**).

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 37</i>

3.4.4 Publikimet e Parashikimeve

3.4.4.1 Parashikimet do t'i paraqiten **Rregullatorit** dhe të gjitha **palëve** të **Sistemit Energjetik** të Kosovës dhe do të publikohen në faqen elektronike të **OSTT**. **OSTT** gjithashtu nëse i kërkohet do të paraqesë detajet e metodologjisë së përdorur në përgatitjen e këtyre parashikimeve.

3.5 Informacioni që i duhet dhënë OSTT

3.5.1 Të përgjithshme

3.5.1.1 I gjithë informacioni që kërkohet t'i jepet **OSTT**-it sipas paragrafëve të mëposhtëm do të jepet sipas gjenerimit të çdo **stabilimenti gjenerues** të lidhur me **Sistemin e Shpërndarjes**.

3.5.2 Mujore

3.5.2.1 Çdo muaj – deri ditën e [14] – të gjithë **OSSH**-të, **përdoruesit e ngarkesës** të lidhur direkt me **Sistemin e Transmisionit** dhe **gjeneratorët** sipas **stabilimenteve** të tyre përkatëse me **njësi prodhuese (gjeneruese)** që kanë një gjenerim më të madh se [1MW] duhet t'i japin **OSTT**-it informacionet e mëposhtme:

- Parashikimet e **ngarkesës** si për **fuqinë aktive** dhe për **fuqinë reaktive** në bazë të **pikës kyçëse** për secilin nga [tre] muajt kalendarik në baza ditore;
- Profilet e **ngarkesës** aktive dhe reaktive për çdo orë për ditën e parashikuar me **ngarkesën e energjisë aktive** në pikën lidhëse maksimale dhe ditën e specifikuar të pikut të **ngarkesës të Sistemit të Transmisionit**;
- Profilet e **ngarkesës** aktive dhe reaktive për çdo orë për ditën e parashikuar me **ngarkesën e fuqisë aktive** në **pikën kyçëse minimale** dhe ditën e specifikuar të **ngarkesës minimale të Sistemit të Transmisionit**;
- Profilet tipike të ngarkesës për çdo orë të ditës të javës, ditës së fundjavës dhe ndaras për ditë pushimi.

3.5.2.2 Data dhe ora e parashikimeve të minimeve dhe maksimeve të **ngarkesës** së **fuqisë aktive** në **pikën kyçëse** do të jepen së bashku me parashikimet e **ngarkesës**. **OSTT**-i do t'u japë të gjitha **palëve** datat e parashikimeve të maksimeve dhe minimeve të **kërkesave për fuqinë aktive të Sistemit të Transmisionit** për çdo muaj dhe do ta publikojë këtë informacion në faqen elektronike të tij.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

3.5.3 Javore

3.5.3.1 Çdo javë – deri [të Premten] të gjithë **OSSH-të, përdoruesit e ngarkesës** të lidhur direkt me **Sistemin e Transmisionit** dhe **gjeneratorët** sipas stabilimenteve të tyre përkatëse me **njësi prodhuese (gjeneruese)** që kanë një gjenerim më të madh se [1MW] duhet t'i japin **OSTT** informacionet e mëposhtme:

- Parashikimet e **ngarkesës** si për **fuqinë aktive** dhe për **fuqinë reaktive** në bazë të **pikës lidhëse** për secilin nga [tre] javët duke filluar nga e diela – në bazë ore;

3.5.4 Çdo ditë

3.5.4.1 Të gjitha **palët tregtare** duhet t'i sigurojnë **Operatorit të Sistemit** një informacion të **parashikimit të ngarkesës** sipas orës për ditën në vazhdim deri në orën [09,00] dhe duhet t'i rifreskojnë këto parashikime për të mbajtur në konsideratë ndonjë ndryshim në këto parashikime.

3.6 Parashikimet e Gjenerimit

3.6.1 Të përgjithshme

3.6.1.1 Parashikimet e **gjenerimit** i duhen **OSTT-it** për të kryer vlerësimin e sigurisë së **Sistemit Energjetik**. Informacioni i dhënë në këtë paragraf i shtohet çdo informacioni që kërkohet sipas **kodit të koordinimit të ndërprerjeve**. Kërkesat janë të detajuara në paragrafët në vazhdim.

3.6.2 Mujore

3.6.2.1 Çdo muaj – deri ditën e [14-të] – të gjithë **gjeneratorët** sipas stabilimenteve të tyre përkatëse me **njësi prodhuese (gjeneruese)** që kanë një gjenerim më të madh se [1MW] duhet t'i japin **OSTT-it** informacionet e mëposhtme për vitin e ardhshëm në baza javore:

- Disponueshmërinë e stabilimentit të synuar – duke mbajtur në konsideratë çdo **ndërprerje** të propozuar të njoftuar sipas **kodit të koordinimit të ndërprerjeve**;
- Pengesat e energjisë;
- Kushte të tjera të stabilimentit që mund të ndikojnë fizikisht në sigurinë e **Sistemit Energjetik**;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

3.6.3 Javore

3.6.3.1 Deri [të Premten] e çdo jave të gjithë **gjeneratorët** sipas **stabilimenteve** të tyre përkatës me **njësi prodhuese (gjeneruese)** që kanë një gjenerim më të madh se [1MW] duhet t'i japin **OSTT**-it informacionet e mëposhtme për [tetë] javët në vazhdim në baza ditore:

- Disponueshmërinë e stabilimentit të synuar – duke mbajtur në konsideratë çdo **ndërprerje** të propozuar të njoftuar sipas **kodit të koordinimit të ndërprerjeve**;
- Pengesat e energjisë;
- Kushte të tjera të stabilimentit që mund të ndikojnë fizikisht në sigurinë e **sistemit energjetik**:

3.6.4 Çdo ditë

3.6.4.1 Çdo ditë të gjithë **gjeneratorët** sipas **stabilimenteve** të tyre përkatëse me **njësi prodhuese (gjeneruese)** që kanë një gjenerim më të madh se [1MW] duhet t'i japin **OSTT** informacionet e mëposhtme për [shtatë] ditë duke filluar me D + 2:

- Disponueshmërinë e stabilimentit të synuar;
- Kohët e caktuara për sinkronizimin/desinkronizimin të **njësisë prodhuese (gjeneruese)** për **njësitë prodhuese (gjeneruese)** me start të ngadalshëm;
- Nivelet e parashikuara të **vetë-dispeçimit**;
- Kushte të tjera të stabilimentit që mund të ndikojnë fizikisht në sigurinë e **sistemit energjetik**:

3.7 Parashikimi i Ngarkesës për Ditën në Vazhdim

3.7.1.1 Secila **palë tregtare** është përgjegjëse sipas **rregullave të tregut** për çekuilibrat e saj të energjisë por **OSTT**, si **Operator i Sistemit** duhet të bëjë parashikimin e tij të **ngarkesës**. Ky parashikim do të përfshijë një vlerësim të humbjeve në **transmision** dhe nevojat e brendshme të **OSTT** dhe do të bazohet në faktorët e mëposhtëm:

- kërkesa historike;
- parashikimi i motit;
- periudha e vitit;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- dita e javës;
- ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme:

3.7.1.2 Parashikimi do të mbuloj vetëm ngarkesën në Kosovë dhe nuk do të përfshij transferimet nga interkoneksionet

3.7.2 Përmbajtja e Parashikimit të Ngarkesës për Ditën në Vazhdim

3.7.2.1 **Parashikimi i ngarkesës** së ditës në vazhdim do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- Kërkesa e pritshme për çdo orë (në MW) nga shuma e të gjitha pikave të mbledhjes në **zonat shpërndarëse**;
- **Ngarkesa** e pritshme e pashërbyer (në MW);
- Margjina e rezervës së **OSTT** për çdo orë;

3.7.2.2 Ky **parashikim i ngarkesës** së ditës në vazhdim do të publikohet deri në orën [10,00] në ditën përpara **ditës së dispeçimit fizik**.

3.7.3 Freskimi i Parashikimit të Ngarkesës

3.7.3.1 **OSTT** do të ofrojë parashikime të freskuara sipas nevojave të **rregullave të tregut** siç është detajuar në paragrafët e mëposhtëm.

3.7.3.2 Sipas ditës në vazhdim pas **ditës së dispeçimit fizik** deri në orën [16,00] dhe [22,00].

3.7.3.3 Sipas pjesës së mbetur të **ditës së dispeçimit fizik**⁴ deri në orën [06,00] dhe [12,00].

3.7.4 Raportimi i Operatorit të Sistemit

3.7.4.1 **OSTT**-it do t'i kërkohej të raportoj për **palët tregtare** dhe **Rregullatorin** në bazë javore si më poshtë:

- Çdo incident ku parashikimi i **kërkesës** së tregut dallon prej parashikimit të kërkesës nga **OSTT** e vlerësuar me më tepër se [50]MW;
- Çdo incident ku **ngarkesa** e prodhimit aktual dallon për më shumë se [50]MW nga vlerësimi i **OSTT** ose kërkesa e tregut.

⁴ Megjithë faktin që këto parashikime do të jenë për ditën e dispeçimit fizik ato do të quhen parashikime të kërkesës për ditën në vazhdim.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 37</i>

3.8 Kërkesat për Rezerva

- 3.8.1.1 **Operatori i Sistemit** do të vlerësojë në baza ditore parashikimet afatgjate për rezervat dhe do t'i përshtatë ato ku është e nevojshme. Kërkesat për rezerva do të marrin parasysh ngarkesën, numrin e **njësive prodhuese (gjeneruese)** në funksionim, nivelet e tyre të gjenerimit dhe përdorimin e interkonekcioneve.
- 3.8.1.2 **Operatori i Sistemit** do të sigurojë rezervën që konsiderohet e nevojshme për mbajtjen e niveleve të përshtatshme të sigurisë së sistemit ndërsa shkaktohen kostot më të ulëta ose nga **tregu i balancimit** ose nga kontratat e rezervave.

3.9 Kapaciteti i Interkonekcioneve

- 3.9.1.1 **Operatori i Sistemit** në interkoneksion me **TSO**-të e **palëve** të interkonektuara do të përcaktojë kapacitetin e secilit qark të interkoneksionit për secilën orë të ditës në vazhdim. Ky informacion do t'i bëhet i ditur **Operatorit të Tregut** deri në orën [10,00] në ditën para **ditës së dispeçimit fizik**.
- 3.9.1.2 Në rast se ka ndonjë ndryshim në kapacitetin e interkoneksionit për çdo pjesë të ditës në vazhdim **Operatori i Sistemit** do të informojë menjëherë **Operatorin e Tregut**.

3.10 Mënyra e Rastësishme

- 3.10.1.1 Në rast se një **OSSH** ose një **përdorues i ngarkesës** i lidhur direkt me **Sistemin e Transmisionit** ose një **gjenerator** bëhet i vetëdijshëm për një ndryshim të madh dhe të rëndësishëm në cilëndo prej parashikimeve të dhëna nga **OSTT** atëherë ata duhet menjëherë të japin parashikimet e freskuara.

3.11 Vlerësimi i Sigurisë

3.11.1 E Përgjithshme

- 3.11.1.1 **OSTT** do të përpiqet të bëjë të pamundurën që të mbajë sigurinë e **sistemit energjetik** në përputhje me standardet e sigurisë së operimit ndërsa e lejon tregun të funksionoj në mënyrë efikase me minimumin e ndërhyrjeve.
- 3.11.1.2 **OSTT** ka përgjegjësinë e vlerësimit, mirëmbajtjes dhe rinovimit të sigurisë së furnizimit dhe vazhdimësisë në afatet kohore të funksionimit. Këto kërkesa përfshijnë afatet kohore si më poshtë:

- Afat gjata – një vit në vazhdim – kjo mbulohet nga PSSA mujore sipas seksionit 3.12.1;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Sezonale – për sezonet e dimrit dhe të verës të UCTE – kryesisht për qëllimin e vlerave të koordinuara paraprake të NTC në të gjitha vijat lidhëse brenda interkoneksionit sipas seksionit 3.12.2;
- Afat mesme – [tetë] javë në vazhdim – kjo mbulohet nga PSSA javore sipas seksionit 3.12.3;
- Afat shkurta – dita në vazhdim – kjo mbulohet nga dispozitat e kodit të vlerësimit të sistemit (brenda **kodit të planifikimit operativ**);

3.11.1.3 Për vlerësimin e sigurisë së sistemit **OSTT** duhet të marrë në konsideratë informacionin e dhënë sipas kërkesave të këtij kodit të vlerësimit të sistemit dhe çdo informacioni tjetër të lidhur që është i gatshëm kohë pas kohe.

3.11.2 Procesi

3.11.2.1 Në vlerësimin e sigurisë të **sistemit energjetik, OSTT** do të ndjekë një proces të tërë dhe gjithëpërfshirës që përfshin këto faza kryesore:

- Grumbullimin e informacionit;
- Analizën e informacionit;
- Publikimin e vlerësime afatgjata dhe afatmesme të sigurisë së **sistemit energjetik**.

3.11.3 Grumbullimi i informacionit

3.11.3.1 Informacioni që do të grumbullohet nga **OSTT** të cilin do ta përdorë në vlerësimin e sigurisë së sistemit është i detajuar në këtë kod të vlerësimit të sistemit. Të gjitha palët e lidhura nëpërmjet termave të këtij **Kodi të Rrjetit** do të japin informacionin e detajuar në këtë kod të vlerësimit të sistemit dhe të gjitha të dhënat e tjera të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga **OSTT**. Të dhënat duhet të dërgohen sipas kohës së caktuar dhe duhet të tregohet shumë kujdes për të siguruar që të dhënat janë të sakta dhe të besueshme.

3.11.4 Analiza e Informacionit

3.11.4.1 Procesi i analizës së informacionit do të ndërmerret nga **OSTT** në mënyrë që të prodhojë vlerësimet e sigurisë që do t'i jepen të gjitha **palëve** sipas përcaktimit në paragrafin 3.11.6.

3.11.4.2 Kjo analizë e vlerësimit të sigurisë do të përdorë informacionin e mbledhur sipas paragrafit 3.11.3 më sipër dhe do të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion të **OSTT**.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

Këto mund të përfshijnë mjete në kohë reale dhe jo në kohë reale dhe metodat e përdorura do të zgjidhen vetëm nga **OSTT**. **OSTT** duhet t'i dokumentoj këto metoda dhe duhet t'i vendosë në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe të **Rregullatorit**.

3.11.5 Ruajtja e Fshehtësisë

3.11.5.1 **OSTT** është përgjegjës për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave të mbledhura për qëllimet e vlerësimit të sistemit dhe të planifikimit operativ dhe do të kujdeset për fshehtësinë e të dhënave gjatë shkëmbimit të këtyre të dhënave për qëllime operative me **TSO**-të e tjera. Këto të dhëna mund të jenë të ndjeshme nga ana komerciale dhe fshehtësia do të respektohet sipas marrëveshjeve bilaterale dhe dispozitave të këtij **Kodi të Rrjetit**.

3.11.6 Publikimi

3.11.6.1 **OSTT** duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që t'i japë të gjitha **palëve** informacionin të mjaftueshëm. Do të publikojë në faqen elektronike të tij vlerësimet e sigurisë të **sistemit energjetik** (PSSA) duke dhënë vlerësime të sigurisë së sistemit për të tashmen dhe të ardhmen me detaje të mjaftueshme dhe në intervalet e rëna dakord me **Rregullatorin** në mënyrë që të sigurojë se të gjitha **palët** janë të informuara në mënyrën e duhur për t'iu lejuar atyre të marrin vendime për funksionimin efikas dhe ekonomik të aseteve të tyre. PSSA-të do bëjnë si më poshtë:

- Do të asistojë **përdoruesit** në planifikimin e punëve të caktuara sipas orarit në **stabilimente dhe/ose aparate**;
- Do të informojë të gjitha **palët** për çështje potenciale të mundshme të sigurisë së **sistemit energjetik**.

3.12 Vlerësimet e Sigurisë të Sistemit Energjetik (PSSA-të)

3.12.1 PSSA Mujore

3.12.1.1 **OSTT** do të përgatisë dhe publikojë një PSSA mujore çdo muaj deri në ditën e [20] të muajit. Ai do të mbulojë periudhën një vjeçare që fillon në muajin që menjëherë pason publikimin. Informacioni që përmban PSSA mujore do të punohet me një zgjidhje prej një jave.

3.12.1.2 PSSA mujore duhet të mbulojë vitin në vazhdim dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- **Parashikimet e ngarkesës** – këto do të mbulojnë vitin në vazhdim me një zgjidhje [javore] dhe ditët e maksimumeve dhe minimumeve të **ngarkesës** me një zgjidhje për çdo [orë];

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 37</i>

- Për çdo muaj kalendarik **kërkesa** mesatare për çdo orë për një mesatare për ditët e biznesit në atë muaj dhe të dhënat ekuivalente sa i përket ditës mesatare që nuk është **ditë biznesi** në secilin muaj;
- Kërkesat e parashikuara të rezervës në mënyrë që të përmbushin **standardet e sigurisë për sistemin energjetik** të Kosovës;
- **Gjenerimi** në dispozicion – kapaciteti total i pritshëm i **gjenerimit** në dispozicion duke bërë zbritjet për ndonjë **njësi prodhuese (gjeneruese)** apo **stabiliment energjetik** që kanë pengesa energjetike ose pengesa për arsye të tjera në baza [javore];
- Kërkesa maksimale e pritshme dhe kërkesa mesatare për çdo orë (secila në MW) në lidhje me çdo muaj të vitit kalendarik në vazhdim.
- Vlerësimet e humbjeve në transmision në GWh në baza [javore];
- Vlerësimet e pengesave në **sistem** në GWh me një zgjidhje [javore];
- Detajet e ndonjë situatë të projektuar ku **standardet e sigurisë për Sistemin Energjetik** të Kosovës do të shkelen:

3.12.1.3 **OSTT** do t'i vendosë PSSA-të mujore në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe **Rregullatorit** në versione elektronike dhe do t'i publikojë ato në faqen elektronike të tij.

3.12.2 PSSA-të sezonale

3.12.2.1 **OSTT** do të punojë dhe publikojë PSSA sezonale dy herë në vit në [Mars] dhe [Shtator]. Do të mbulojë vitin në vazhdim për sezonet e dimrit dhe verës kryesisht për kapacitetin e interkoneksionit. PSSA sezonale do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Parashikimet e **ngarkesës** – një parashikim i **ngarkesës** maksimale dhe minimale në dimër dhe verë;
- Vlerësimet e kapacitetit transferues maksimal dhe minimal të **interkoneksionit** sipas sezonit;
- Detajet e ndonjë situatë të projektuar ku **standardet e sigurisë për Sistemin Energjetik** të Kosovës do të shkelen:

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>faqe 3 nga 37</i>

3.12.2.2 **OSTT** do t'i vendosë PSSA-të sezonale në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe **Rregullatorit** në versione elektronike dhe do t'i publikojë ato në faqen elektronike të tij.

3.12.3 PSSA-të javore

3.12.3.1 **OSTT** do të punojë dhe publikojë PSSA javore çdo javë deri të [Premten]. Do të mbulojë periudhën [tetë] javore në vazhdim duke filluar në të [Dielën] pasuese. PSSA javore do të punohet në zgjidhje [ditore].

3.12.3.2 PSSA-ja javore do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- **Parashikimet e ngarkesës** – këto do të mbulojnë [tetë javët] në vazhdim me një zgjidhje [ditore] dhe ditët e parashikimeve të **ngarkesës** maksimale dhe minimale me një zgjidhje për çdo [orë]:
- Kërkesat e parashikuara të rezervës në mënyrë që të përmbushin **standardet e sigurisë** për **sistemin energjetik** të Kosovës;
- **Gjenerimin** në dispozicion – kapacitetin total të **gjenerimit** në dispozicion duke bërë zbritjet për ndonjë **njësi prodhuese (gjeneruese)** apo **stabiliment energjetik** që kanë pengesa energjetike ose pengesa për arsye të tjera në baza [ditore]:
- Vlerësimet e humbjeve në transmision në GWh në baza [ditore];
- Vlerësimet e pengesave në **sistem** në GWh me një zgjidhje [ditore];
- Detajet e ndonjë situatë të projektuar ku **standardet e sigurisë** për **Sistemin Energjetik** të Kosovës do të shkelen:

3.12.3.3 **OSTT** do t'i vendosë PSSA-të javore në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe **Rregullatorit** në versione elektronike dhe do t'i publikojë ato në faqen elektronike të tij.

3.12.4 E Përgjithshme

3.12.4.1 **OSTT** mund të përgatisë dhe publikojë versione shtesë të azhurnuara të PSSA-ve mujore, sezonale ose javore në rastet e ndryshimeve të rëndësishme apo arsyeve të tjera që **OSTT** i konsideron të nevojshme.

3.12.4.2 **OSTT** duhet të dokumentojë procedurën e përdorur për përgatitjen e PSSA-ve mujore, sezonale dhe javore dhe ta vendosë këtë informacion në dispozicion të çdo **pale** dhe **Rregullatorit**.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

4 Kodi i Planifikimit Kohor

4.1 Parathënie

4.1.1.1 Ky **kod i planifikimit kohor** përcakton procedurën për caktimin e orareve në shkallën kohore të ditës në vazhdim. Detajon procesin sipas të cilit **OSTT** punon për caktimin e orareve ditore – një orar operativ që merr parasysh kufizimet operative dhe ato të sistemit.

4.1.1.2 Ky **kod i planifikimit kohor** përcakton procedurat që duhen aplikuar nga **OSTT**, në rolin e tij si **Operator i Sistemit**, dhe **pjesëmarrësit e tregut** gjatë caktimit të orareve operative. Detajon procesin sipas të cilit **OSTT** përgatit një draft orar nga dorëzimet ditore të ofruara nga **pjesëmarrësit në treg** dhe **palët e interkonektuara** për të lejuar ndërmarrjen e një vlerësimi të sistemit dhe për të balancuar sistemin në kohë reale. Ky proces do të marrë në konsideratë kongestionin e sistemit dhe ndonjë faktor tjetër operativ.

4.1.1.3 Procedurat e caktimit të orareve janë të lidhura ngushtë me organizimin dhe funksionimin e **tregut të energjisë elektrike**. Në përgjithësi dorëzimet ditore për **gjenerimin** dhe **ngarkesën** do të zhvillohen nga **pjesëmarrësit në treg** që japin të dhëna bazuar në obligimet e tyre kontraktuale sipas transaksioneve bilaterale dhe kërkesave të tyre të përgjithshme të energjisë. Bazuar në dorëzimet fillestare të dorëzuara nga **pjesëmarrësit në treg**, **OSTT** duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të ruajtur ekuilibrin e sistemit dhe për të arritur, me sa është e mundur, transmision të besueshëm të flukseve të caktuara të energjisë.

4.1.1.4 Funksionimi i detajuar i **tregut të energjisë elektrike** dhe rregullimet për funksionimin e tij janë përmbledhur në dokumentin e **rregullave të tregut**.

4.2 Objektivat

4.2.1.1 Objektivat e përgjithshme të këtij kodi të planifikimit kohor janë të dyfishta. Së pari për të siguruar se në të gjitha kohët do të ketë një plan që do të përshtatë **gjenerimin** me **ngarkesën** dhe së dyti për të mbajtur marginën e përshtatshme të rezervës për të siguruar, sa është e mundur, integritetin e **sistemit energjetik** dhe sigurinë dhe cilësinë e furnizimit të **Sistemit Energjetik** të Kosovës në përputhje me **Kodin e Rrjetit** duke:

- Kontrolluar dorëzimet ditore nga **pjesëmarrësit të tregut**;
- Mbajtur llogari të **pengesave të sistemit** dhe të **pengesave të sistemit**;

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Përcaktuar me **palët** e tjera të **interkonektuara** kapacitetin neto të transferimit të secilit qark të interkonektorit
- Planifikuar rotacionin ABC të reduktimit të ngarkesës;
- Përgatitur **oraret e miratuara** duke përdorur informacionet si më sipër;

4.3 Fushëveprimi

Ky seksion aplikohet për si më poshtë:

- **OSTT** në rolin e tij si **Operator i Sistemit** dhe **Operator i Tregut**;
- **OSSH-të**;
- Të gjitha **palët tregtare**:

4.4 Dorëzimet nga Palët Tregtare

4.4.1 Të përgjithshme

4.4.1.1 Në mënyrë që të mbahen siguria dhe stabiliteti i **Sistemit Energjetik** të Kosovës **Operatori i Sistemit** duhet të ketë informacion mbi gjenerimin e planifikuar dhe të gjeneruar dhe konsumin e planifikuar në mënyrë që të planifikojë për mungesat dhe tepricat. **Operatorit të Sistemit** do t'i nevojitet informacioni për balancimin e energjisë dhe për t'u përballur me problemet e tensionit dhe pengesat në sistem.

4.4.2 Lajmërimet Fizike (PN)

4.4.2.1 Secila **palë tregtare** duhet të bëjë një **dorëzim ditor** deri në orën [13,00] për ditën në vazhdim të **ditës së dispeçimit fizik**. Do të dorëzohet në mënyrë elektronike dhe brenda [30] minutash nga **transmisioni** do të njihet nga **Operatori i Sistemit**.

4.4.2.2 Dorëzimi ditor do të përmbajë lajmërimet fizike dhe parametrat dinamik të të dhënave. Përmbajtja dhe formati i informacionit duke përfshirë tolerancat duhet të dorëzohet si është përcaktuar në **rregullat e tregut**.

4.4.2.3 **Lajmërimet fizike** për **interkonektorët** do të dorëzohen në emër të **tregtarëve të interkonektorëve** nga **Operatori i Tregut**.

4.4.2.4 **Operatori i Tregut** do të bëjë një **njoftim fizik PN** të menduar për çdo furnizues në secilën zonë shpërndarje në mënyrë që të llogarisin ngarkesën e pashërbyer.

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

4.4.3 Parametrat e të Dhënave Dinamike

4.4.3.1 **Pala tregtare** duhet të japë **parametrat** e tij të të dhënave dinamike siç detajohet në Aneksin 1 të këtij **kodi të planifikimit operativ**. Nëse **parametrat** e të dhënave dinamike nuk kanë ndryshuar nga **dorëzimi** i mëparshëm atëherë ky fakt duhet të shënohet dhe nuk do të kërkohet **dorëzim** për to.

4.4.4 Kontrollimi dhe Miratimi i Dorëzimeve

4.4.4.1 Pas kohës së **dorëzimit**, **OSTT** duhet të kontrollojë vlefshmërinë e **dorëzimit** të **PN-ve** dhe **DDP-ve** që është marrë nga **OSTT** për secilën **palë tregtare**.

4.4.4.2 Një **dorëzim** do të deklarohet i pavlefshëm nga **OSTT** në secilin nga rastet e mëposhtme:

- Kur nuk është dorëzuar asnjë **dorëzim** deri në kohën e **dorëzimit**;
- **Dorëzimi** nuk përputhet me formatin dhe përmbajtjen e **dorëzimit** siç është përcaktuar në **rregullat e tregut**;
- **OSTT** ka marrë më shumë se një **dorëzim** dhe ata janë kontradiktore;
- **Dorëzimi** përmban injektim nga një **njësi prodhuese (gjeneruese)** që tejkalon kapacitetin e regjistruar të asaj **njësie prodhuese (gjeneruese)**;

4.4.4.3 **Operatori i Sistemit** duhet të aprovojë secilin **dorëzim** që nuk është deklaruar i pavlefshëm. Ky bëhet orari i miratuar i **palës** koresponduese tregtare. Ky **dorëzim** i miratuar do të aplikohet për **ditën** përkatëse të **dispeçimit fizik** dhe të jetë i detyrueshëm për **palën tregtare**. **OSTT** do t'ia dërgojë njoftimin e **dorëzimit** të miratuar secilës **palë tregtare** brenda [30] minutash.

4.4.5 Trajtimi i Dorëzimeve të Pavlefshme

4.4.5.1 Nëse **Operatori i Sistemit** deklaron një **dorëzim** si të pavlefshëm atëherë **Operatori i Sistemit** do të informojë **palën tregtare** të propozuar se **dorëzimi** është deklaruar i pavlefshëm dhe arsyet për pavlefshmërinë e tij. **Pala tregtare** më pas do të dorëzojë një **dorëzim** të korrigjuar brenda [30] minutash.

4.4.5.2 Pas marrjes së **dorëzimit** të korrigjuar, **OSTT** do të kontrollojë vlefshmërinë e në përputhje me kërkesat e seksionit 4.4.4.

4.4.5.3 **OSTT** duhet të merret vesh paraprakisht me secilën **palë tregtare** se çfarë veprimi duhet të merret në rastin kur nuk merret asnjë **dorëzim** i vlefshëm. Nëse nuk ka marrëveshje paraprake, atëherë **OSTT** do të përdorë **dorëzimin** [për ditën e kaluar].

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

4.4.6 Ofertat dhe Propozimet

- 4.4.6.1 Një **palë tregtare** mund të paraqesë **oferta** dhe **propozime** në bazë të **njësive** të saj të **balancimit** sipas **rregullave të tregut**. **Ofertat** dhe **propozimet** e tyre mund të bëhen deri në orën [13,00] të ditës në vazhdim.
- 4.4.6.2 **Operatori i Sistemit** mund të pranojë **oferta** dhe **propozime** nga ora [14,00] në ditën në vazhdim deri më [24,00] të **ditës së dispeçimit fizik**. **Ofertat** dhe **propozimet** mund të jenë për rezerva apo për kërkesa të tjera balancimi sipas **rregullave të tregut**.
- 4.4.6.3 **Operatori i Sistemit** do të pranojë **oferta** ose **propozime** në mënyrë që të krahasojë mospërputhjet ndërmjet shumës së **PN-ve** dhe **parashikimit të ngarkesës**. **Operatori i Sistemit** po ashtu do të pranojë **oferta** dhe **propozime** për të kaluar pengesat e sistemit ose për rezerva shtesë. Çdo **ofertë** apo **propozim** i miratuar duhet të jetë në përputhje me **DDP⁵**-të dhe në veçanti me shkallët e tij të deviacionit. Në fund të periudhës së miratimit njësi balancuese duhet të kthehet në pozicionin e saj të deklaruar të **PN**.

4.4.7 Pezullimi i Tregut të Energjisë Elektrike

- 4.4.7.1 Në kushtet e një force natyrore siç mund të jetë një çrregullim madhor i sistemit energjetik, **Operatori i Sistemit** mund të pezullojë **tregun e energjisë elektrike**. Në këto kushte **Operatori i Sistemit** do të informojë **Operatorin e Tregut, Rregullatorin**, të gjitha **palët tregtare** dhe të gjitha **TSO-të të palëve të interkonektuara** sipas rrethanave.
- 4.4.7.2 Sipas kushteve në paragrafin 4.4.7.1 **Operatori i Sistemit** mund të refuzojë të pranojë ose ofrojë parashikime apo dorëzime.
- 4.4.7.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur **Operatori i Sistemit** do të informojë **Operatorin e Tregut, Rregullatorin**, gjithë **palët tregtare** dhe **TSO-të e palëve të interkonektuara** se tregu i energjisë elektrike do të kthehet apo është kthyer në gjendjen e mëparshme dhe kohën kur kjo ka ndodhur ose do të ndodhë.

4.4.8 Shërbimet Ndhmëse

- 4.4.8.1 Për secilën **njësi balancuese** që është e gatshme si ofruese shërbimesh ndihmëse, **pala tregtare** duhet të dorëzojë një njoftim dispozicioni jo më vonë se ora [13,00] në ditën para ditës së caktuar duke treguar gatishmërinë për ditën e dispeçimit fizik. Njoftimi i dispozicionit minimalisht duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

⁵ DDP – Dynamic Data Parameters

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Gatishmërinë për secilën **njësi balancuese** për ditën në fjalë;
- Programimin e **ndërprerjeve** për **ndërprerje** të ndryshueshme/të pandryshueshme, njoftimin paraprak për **ndërprerjet** e ndryshueshme, mirëmbajtjen e planifikuar afatshkurtër, kohët e rikthimit në shërbim etj;
- Të dhënat e rishikuara MW për periudha të ndryshme të asaj dite të caktuar ku këto të dhëna ndryshojnë gjatë ditës.

4.4.9 Komunikimet

4.4.9.1 Të gjitha komunikimet ndërmjet **Operatorit të Sistemit** dhe **Operatorit të Tregut** dhe ndërmjet **Operatorit të Sistemit** dhe **palëve tregtare** do të kryhen në mënyrë elektronike me një FAX duke mbajtur një kopje të gatshme. Të gjitha komunikimet do të njihen pozitivisht nga pala marrëse brenda [30] minutave nga marrja e tyre.

4.4.10 Formati i Orareve

4.4.10.1 Formati dhe përmbajtja e informacionit të ofruar nga **palët tregtare** dhe **parashikimet e ngarkesës** të përgatitura nga **Operatori i Sistemit** do të jenë përgjegjësia e **OSTT**.

4.4.11 Ditët që nuk janë ditë pune

4.4.11.1 Për të gjitha aktivitetet e lidhura me **parashikimet e kodit të planifikimit operativ, dorëzimet** etj. do të ofrohen për të gjitha ditët që nuk janë ditë pune në vazhdim dhe ditën e parë të biznesit në vazhdim në ditën e fundit të biznesit menjëherë para ditës së parë që nuk është ditë pune. Megjithatë të gjitha **palët tregtare** do të kenë rregullime të caktuara në raste emergjencash, në mënyrë që t'u lejojnë atyre të përgatisin një **parashikim dhe dorëzim** të azhurnuar etj, në rastin e ndonjë ndryshimi të rëndësishëm në programin e tyre.

4.4.12 Ndryshimet të Orareve të Aprovuara në Rast Emergjence

4.4.12.1 **Palët tregtare** mund të ndryshojnë **dorëzimet** e tyre të aprovuara pas kohës së dorëzimit, përveç rasteve kur **Operatori i Sistemit** ka deklaruar një situatë gjendje të jashtëzakonshme. Megjithatë **Operatori i Sistemit** nuk është i obliguar të pranojë **dorëzimin** e ndryshuar.

4.4.12.2 Nëse ndryshimi është nxitur nga një defekt në sistem i njoftuar nga **Operatori i Sistemit** ose një **OSSH** relevante atëherë ndryshimi duhet të pranohet nëse si pasojë e këtij defekti ka ndodhur njëra nga pikat e mëposhtme:

- **Kërkesa e palës tregtare** është ulur me të paktën [10MW];

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- **Gjenerimi i palës tregtare** është penguar me të paktën [10MW];
- Nëse një **njësi prodhuese (gjeneruese)** me kapacitet nominal prej të paktën [10MW] ka pasur një **ndërprerje** të papritur;
- Nëse **kërkesa e palës tregtare** është ulur me të paktën [10MW] nga një konsumator i vetëm për arsye që nuk mund të ishin parashikuar nga **pala tregtare** si për shembull **ndërprerja** e papritur e pajisjeve prodhuese (gjeneruese);
- Nëse **Operatori i Sistemit** ka shkurtuar shkëmbimet përgjatë një interkoneksioni të jashtëm:

4.4.12.3 Kur kërkohet të ndryshohen **dorëzimet** e aprovuara në përputhje me 4.4.12.2 **pala tregtare** duhet të ofrojë dëshmi të mjaftueshme. Dëshmia me shkrim mund të dorëzohet brenda maksimum [10] ditë pune.

4.4.12.4 Në rastet e cituara në 4.4.12.1, palët tregtare duhet të lejohen të ndryshojnë **dorëzimet** e tyre të aprovuara deri [30] minuta para orës së plotë që pason kërkesën e palës tregtare për ndryshimin e **dorëzimit** të aprovuar.

4.4.12.5 Çdo ndryshim në **dorëzimet** e miratuara në përputhje me 4.4.12.4 duhet të jetë i kufizuar në:

- Ekuilibrin e humbur si rezultat i **gjenerimit** ose **ngarkesës** së humbur;
- Të gjitha intervalet e orareve që fillojnë në orën e plotë që pason **ngarkesën e palës tregtare** për të ndryshuar dorëzimin e saj të miratuar:

4.4.12.6 Çdo kërkesë nga një **palë tregtare** për të ndryshuar **dorëzimin** e saj do të pranohet vetëm nga **Operatori i Sistemit** nëse **dorëzimi** i ndryshuar nuk do të ishte deklaruar i pavlefshëm në përputhje me seksionin 4.4.4.

5 Shtojca 1 – Parametrat e të Dhënave Dinamike

5.1.1 E përgjithshme

5.1.1.1 **Parametrat e të dhënave dinamike (DDP-të)** duhet të përmbajnë, për secilën **njësi prodhuese (gjeneruese)** me kapacitet të instaluar prej të paktën [10MW], si minimum informacionin e përmendur në paragrafët në vazhdim.

5.1.2 Të dhënat e Disponueshmërisë

5.1.2.1 Të dhënat e disponueshmërisë, secila e shprehur në formën e kohës së disponueshme/padisponueshme nga (si datë/muaj/vit) ose përndryshe si kohëzgjatje (orë:minutë) si më poshtë:

- **Ndërprerja** e planifikuar;
- **Ndërprerja** e shpejtë;
- Koha minimale e fikjes;
- Koha minimale e kyçjes;

5.1.3 Të Dhënat e Shkallës së Devijimit

5.1.3.1 Të dhënat e shkallës së devijimit të shprehura në formën e ndryshimeve MW/minutë në gjenerim duke përfshirë:

- Shkallën e rritjes së pakufizuar
- Shkallën e rritjes së kufizuar mbi MSG⁶;
- Shkallën e rritjes nën MSG;
- Shkallën e rënies së pakufizuar;
- Shkallën e rënies së kufizuar mbi MSG;
- Shkallën e rënies nën MSG;

⁶ MSG – Minimum Stable Generation

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

5.1.4 Kufijtë Operativ

5.1.4.1 Kufijtë operativ të shprehur në MW (ose në MWh dhe orë:minutë në rastin e kufijve të shpërndarjes të lidhur me stabilimentin hidro).

- MEL⁷ (Kufiri Maksimal i Eksportit për një stabiliment gjenerues);
- MIL⁸ (Kufiri Maksimal i Importit për një njësi në anën e ngarkesës);
- Volumi Maksimal i Shpërndarjes;
- Periudha Maksimale e Shpërndarjes;
- MSG (Minimumi i Qëndrueshmërisë së Gjenerimi);
- MSG i Pakufizuar;

5.1.5 Kërkesat për Njoftim

5.1.5.1 Kërkesat për njoftim të shprehura në orë minutë që nevojiten nga gjeneruesit për t'iu përgjigjur një udhëzimi nga **Operatori i Sistemit** që përfshinë:

- Njoftimin për të Devijuar nga Zeroja;
- Njoftimin për të Shpërndarë Ofertë;
- Njoftimin për të Shpërndarë Propozim:

5.1.6 Informacion tjetër për Njësine Gjeneruese

5.1.6.1 Përfshin të dhënat e mëposhtme:

- Përkuljet në Rregullatorin e Shpejtësisë (%);
- Në rastin e turbinave me avull, kohët e sinkronizimit për nivelet e ndryshme të ngrohtësisë dhe për më tepër koha nga sinkronizimi deri në ngarkesën e dispeçimit;
- Në rastin e strukturave hidro dhe po ashtu të turbinave me gaz, koha nga lëshimi i fillimit deri në arritjen e ngarkesës së dispeçimit;

⁷ MEL – Maximum Export Limit

⁸ MIL – Maximum Import Limit

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

- Kufizimet në numrin e lëshimeve për ditë të caktuara;
- Ngarkesa e bllokut në MW që pason sinkronizimin;
- Shkallët maksimale të ngarkesës për nivelet e ndryshme të nxehtësisë;
- Shkallët maksimale të shkarkimit;
- Kufijtë e kapacitetit MW dhe MVAr brenda të cilave **njësia prodhuese (gjeneruese)** është në gjendje të funksionojë si është treguar në diagramin e kapacitetit të **njësisë prodhuese (gjeneruese)** përkatëse;
- Numri maksimal i cikleve në ngarkesë për periudhën 24 orëshe, së bashku me rritjet maksimale në ngarkesë të përfshira.

5.1.7 Caktimi i Orareve nga Ana e Ngarkesës dhe Parametrat e Dispeçimit (DSP)

5.1.7.1 Si minimum, DSP⁹ duhet të paraqesë, për të gjitha shërbimet e dispeçimit nga ana e ngarkesës:

- Lokacionin;
- Sasinë;
- Aranzhmanet automatike;
- Kohën e zbatimit;

6 Burimet dhe Dokumentet

6.1 Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Ligji për Energjinë Elektrike
2.	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
3.	
4.	

6.2 Dokumentet dhe formularët

Balancet e Energjisë

⁹ DSP – Demand Side Parameters

	KODI I RRJETIT	PO-KO-005
	<i>ver. 2.1</i>	<i>fajqe 3 nga 37</i>

6.3 Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.1	27.01.2007	Edicioni 1, Rishikimi 1	1 vit
2.0	14.01.2008	Edicioni 2	2 vjet
2.1	10.09.2010	Edicioni 2, Rishikimi 1	